



**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
Sektori i Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale**

Analiza e Profesionit

“KASAP”

Tiranë, Shkurt 2017

Përshkrimi i Profesionit “KASAP”

Emërtimi i profesionit	KASAP
Kodi i profesionit	7511.04
Niveli i kompetencës	II
Përshkrim i përgjithshëm i profesionit “Kasap”	
<p>Kasapi pastron, ther, rrjep, pret mishin dhe peshkun, si dhe përgatit artikuj të ngjashëm ushqimorë për shitje. Ai mund të punësohet në ferma, kompani shërbimesh e prodhimesh të këtyre artikujve apo të vetëpunësohet.</p>	
Funksionet kryesore	
<p>Kasapi kryen një pjesë ose tërësinë e funksioneve të mëposhtme, sipas mënyrës së organizimit të punës:</p>	
<ul style="list-style-type: none">➤ Vesh uniformën;➤ Zbaton rregullat higjieno sanitare;➤ Vesh doreza metalike;➤ Pastron vendin e punës;➤ Verifikon raportin mjekësor të gjendjes shëndetësore të kafshës;➤ Përzgjedh mjetet e punës;➤ Sistemon pajisjet në vendet e punës;➤ Parapërgatit kafshën dhe shpendët për therje;➤ Mbyt kafshën me pistoletë;➤ Mbyt kafshën me elektroshok;➤ Ther kafshën apo shpendin me thike;➤ Heq kokën e vicit / lopës/ shpendit nga trupi;➤ Largon gjakun nga kafsha e therur;➤ Rrjep lëkurën e vicit dhe lopës duke përdorur makinerinë;➤ Rrjep lëkurën e bagëtive të imta me thike dhe apo me fryrje;➤ Depilon lëkurën e derrit;➤ Rrjep derrin me makineri;➤ Heq puplat në autoklavë / me përvëlim;➤ Shkëput këmbët nga trupi i kafshës/ shpendit;➤ Përcëllon thundrat e kafshëve / shpendëve➤ Heq thundrat nga këmbët e kafshës➤ Var kafshët sipas llojit në çengel për kullim dhe maturim;➤ Veçon zorrët, plëndësin, mëlçinë, mushkëritë, zemrën etj. nga trupi i kafshës së rrjepur;➤ Parapërgatit organet e brendshme / kokën dhe këmbët e kafshëve për tregtim ose përpunim të mëtejshëm;➤ Bën ndarjen e vicit në 4 pjesë;	

- Ndan derrin në dy pjesë;
- Kryen maturimin e kafshëve dhe shpendëve;
- Kryen ruajtjen e mishit në kushtet e duhura sipas llojit dhe mënyrës së përdorimit;
- Kryen ndarjen e anatomike të derrit;
- Kryen ndarjen anatomike të lopës dhe vicit;
- Kryen ndarjen anatomike të bagëtive të imta;
- Kryen ndarjen anatomike të shpendëve;
- Dërgon mishin në repartet përkatëse sipas llojit të prodhimit;
- Grin mishin me makineri;
- Bën veshjen e mishit të bagëtive të imta me rizë;
- Kryen peshimin e mishit;
- Kryen paketimin e mishit;
- Pastron dhe dezinfekton vendin e punës;
- Pastron dhe dezinfekton mjetet e punës ;
- Zbaton rregullat e sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit;
- Zbaton rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

Kërkesat për punësim

- Te ketë kryer kurse kualifikimi në specialitetin përkatës apo në shumë raste eksperiencë disavjeçare është e mjaftueshme për punësim
- Te ketë kryer arsimin e detyruar
- Te jete mbi moshën 16 vjeç
- Te ketë certifikatë mjekësore

Informacion shtesë për profesionin Kasap

Njohuritë e nevojshme

- Te njohë rregullat e higjienës
- Të njohë ndërtimin dhe organizimin e thertoresh
- Te njohë rregullat e sigurimit teknik
- Te njohë rregullat e ruajtjes së mjedisit
- Te njohë mënyrat e komunikimit
- Te njohë rregullat e etikës
- Te njohë pajisjet dhe përdorimin e tyre
- Të njohë makineritë dhe përdorimin e tyre
- Të përzgjedhë siç duhet detergjentet
- Llojet e kafshëve dhe të shpendëve
- Të njohë ndarjen anatomike të kafshëve dhe shpendëve
- Të njohë standardet HACCP dhe ISO
- Të njohë mënyrat e ruajtjes dhe përpunimit sipas llojit dhe përdorimit të tyre
- Të njohë mënyrat e mbyjtjes dhe të therjes së kafshëve sipas llojit të kafshëve dhe shpendëve
- Të njohë mënyrat e rrjepjes së kafshëve sipas llojit të kafshëve dhe shpendëve

Sjellja në punë

- I komunikueshëm
- Korrekt
- I ndershëm
- I durueshëm
- Këmbëngulës
- I shpejte
- I shkathet
- Te jete jo alkoolist
- I palodhur
- I fuqishëm

Hapat e karrierës

- Punëtor ndihmës
- Punëtor i kualifikuar
- Teknolog i mesëm
- Drejtues prodhimi